



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 885/4 prot.

Tiranë, më 16. 08. 2022

**V E N D I M**

**Nr. 164, datë 16. 08. 2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 41 Regj., datë 10.02.2022, e D. Sh., kundër Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural<sup>1</sup>, me pretendimin për diskriminim për shkak të *“gjendjes arsimore”*<sup>2</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, D. Sh., shprehet se ka marrë dijeni se në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, është publikuar shpallja nr. 3915, për një vend pune në pozicionin Specialist për Kooperimin dhe Ekonominë e Fermës, në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër. Sipas ankueses, fillimisht është bërë njoftimi për lëvizje paralele, për personat që janë pjesë e shërbimit civil dhe janë të interesuar për transferimin në këtë pozicion pune. Njoftimi për lëvizje paralele është bërë për kategorinë ekzekutive të punonjësve të shërbimit civil.

Ankuesja është e punësuar në pozicionin e financieres, në kategorinë ekzekutive, pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës. Duke qenë se vendi i saj i punës është në qytetin e Lezhës dhe ajo jeton në Shkodër, ka paraqitur dokumentacionin përkatës për t’u transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin e shpallur nga ana e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër.

Sipas saj, në momentin që është njohur me kriteret e lëvizjes paralele për këtë pozicion pune, ka evidentuar se një prej tyre ishte ai i mesatares, ku kërkohej *“Të ketë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00-10.00”*. Duke qenë se bëhej fjalë për nëpunës që janë pjesë e

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën MBZHR

<sup>2</sup> Si rezultat i vendosjes së kriterit të notës mesatare për vendin vakant.

shërbimit civil, ankuesja ka menduar se kriteri është vendosur gabimisht dhe nuk do të merrej në konsideratë gjatë vlerësimit të kandidatëve. Pavarësisht këtij fakti, ankuesja ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar për procedurën e lëvizjes paralele.

Më datë 07.02.2022, është njoftuar me anë të e-mail-it nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore në MBZHR, për skualifikimin e saj për disa arsye, një ndër të cilat ishte “*mosplotësimi i kriterit të notës mesatare 9.00-10.00*”.

Sipas ankueses, vendosja e një kriteri të tillë gjatë procedurave të lëvizjes paralele, është jashtë çdo standarti dhe diskriminues, pasi ka sjell përjashtimin dhe ndalimin e të gjithë kandidatëve, nëpunës të shërbimit civil në pozicione të kategorisë ekzekutive, por që nuk kanë mesataren e studimeve mbi 9.00. Në këtë kuptim ankuesja pretendon se: “*...Unë personalisht, por dhe punonjës të tjerë në të njëjtat kushte me mua, i kemi fituar vendet ekzistuese të punës bazuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe të ligjeve specifike të pozicionit. Prandaj, është e papranueshme që një institucion, në këtë rast MBZHR, të vendos kritere që bien ndesh me ligjin dhe të na përjashtojë nga lëvizja paralele brenda shërbimit civil. Me të vërtetë që në rastin e skualifikimit tim ka patur edhe arsye të tjera, por unë asnjëherë nuk kam pranuar dhe nuk do të pranoj që me to të abuzohet. Nuk lejoj që të vendoset apo shtohet asnjë arsye e padrejtë në rezultatet e konkurimit tim, qoftë ai edhe skualifikues...këtë ankesë po e paraqes para Komisionerit vetëm për kriterin diskriminues të vendosjes së notës mesatare mbi 9.00. Unë di raste të kolegëve të mi nga institucionet e tjera të cilët nuk kanë aplikuar për të vetmen arsye të kriterit përjashtues të notës mesatare*”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim e saj për shkak të gjendjes arsimore, si rezultat i vendosjes së kriterit të notës mesatare, si dhe të detyrojë MBZHR-në ta heq këtë kriter dhe të përsërisë procedurën e konkurimit për pozicionin e sipërcituar të shpallur vakant.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë,*

*që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 295/1 prot., datë 17.02.2022, Komisioneri i është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës<sup>3</sup> së sipërcituar, MBZHR me shkresën nr. 802/2 prot., datë 02.03.2022, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike ka publikuar shpalljen e procedurës për lëvizje paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicionit:

*Specialistë (Kooperimin dhe Ekonominë e Fermës) në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, kategoria: IV-b, shpallja nr. 3915.*

*Sa më sipër, ky pozicion sipas legjislacionit u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rastet se ky pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, atëherë është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategoritë ekzekutive.*

*Sipas përcaktimeve ligjore në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bëhet verifikimi paraprak i kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.*

*Sa më sipër, aplikanti përkatësisht D. Sh., ka dorëzuar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Kërkesë për lëvizje paralele” protokolluar me Nr. 622, datë 31.1.2022. D. Sh.,*

---

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 295/2 prot., datë 03.03.2022

është njoftuar nëpërmjet e-mailit më datë 7.2.2022, se nuk është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, pasi:

1. Nuk ka plotësuar kriterin e mesatares së ponderuar si kriter i vendosur për pozicionin e punës (të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00-10.00 ose ekuivalent për studentët e diplomuar jashtë vendit);
2. Vërtetimi i masës disiplinore nuk është i muajit të fundit;
3. Raporti mjekësor, nuk evidentohet data e marrjes nga mjeku i familjes;
4. Nuk ka dorëzuar vlerësimin e rezultateve në punë për 6-mujorin e fundit (vlerësimi është i 6-mujorit të parë të vitit 2021).

Gjithashtu, në vijim të këtij komunikimi i është bërë me dije se në zbatim të pikës 11, Kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim.

Nga verifikimi i kryer pranë zyrës së Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka rezultuar se D. Sh. nuk ka paraqitur ankesë sipas përcaktimeve ligjore.

Në lidhje me kërkesën tuaj, nëse ka patur raste ku kandidatë të tjerë kanë kundërshtuar vendosjen e kriterit të mesatares për procedurën e lëvizjes paralele, ju bëjmë me dije se deri tani nuk ka pasur raste të ngjashme pranë MBZHR-së.

Në lidhje me kërkesën tuaj, nëse ka punonjës të emëruar në pozicionin për të cilin është shpallur procedura e konkurimit, ju bëjmë me dije se, nuk ka punonjës të emëruar në këtë pozicion përderisa është shpallur si procedurë për konkurim.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, në zbatim të VKM-së nr. 586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, deri më datë 2.2.2022, në këtë pozicion ka qenë i punësuar student i ekselencës. Pas përfundimit të marrëdhënieve të punës nga ana e studentit ekselent, institucioni që mbarë këtë pozicion e ka hedhur në sistemin e Regjistrimit Qëndror të Personelit ose siç njihet ndryshe sistemi HRMIS (sistem që administrohet nga DAP), si pozicion vakant...”.

2. Me anë të shkresës së protokolluar pranë KMD-së me nr. 295/4, datë 07.03.2022, ankuesja ka vënë në dispozicion të Komisionerit shkresën nr. 744/1 prot., datë 25.02.2022, të Departamentit të Administratës Publike, e cila do të analizohet më poshtë gjatë arsyetimit të vendimit.
3. Me anë të shkresës<sup>4</sup> datë 02.03.2022, ankuesja i është drejtuar Komisionerit duke sqaruar ndër të tjera se:

“...Nisur nga kërkesat specifike të shkresës suaj dhe kontakteve shkresore me Departamentin e Administratës Publike dëshiroj tju informoj dhe sqaroj si më poshtë:

Pas kërkesës sime për informacion drejtuar DAP, të protokolluar me datë 03.02.2022, ky institucion më ka kthyer përgjigje (jashtë afateve kohore që jep ligji, pas shkresës së KMD),

---

<sup>4</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 295/3 prot., datë 04.03.2022

konkretisht shkresa mban datën 25.02.2022 dhe nr. 744/I prot.. (shkresa bashkëngjitur). Shkresa e DAP përmban disa pasaktësi, megjithatë unë dua të përqëndrohem dhe të sqaroj vetem dy pika me interes në çështjen që po shqyrton Komisioneri.

Së pari, në faqen e dytë, në pjesën ku shkruan 'Së dyti' shprehet se procedura e konkurrimit është bërë bazuar edhe në VKM nr. 586, datë 30.08.2019 "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore". Ky fakt nuk është i vërtetë pasi në bazën ligjore që përmendet në shpalljen nr. 3915 në faqen zyrtare të DAP nuk përmendet në asnjë rast ky Vendim i Qeverisë. VKM nr. 586, dt. 30.08.2019 përcakton procedurën e punësimit të përkohshëm për studentët ekselentë që punësohen për herë të parë në shërbim civil dhe nuk vlen dhe as nuk zbatohet për lëvizjet paralele brenda shërbimit civil. Pra, kjo bazë ligjore është shtuar tani në shkresën e DAP pas kontakteve me MBZHR (siç shprehet vetë në shkresë). Kjo më bën të dyshoj që MBZHR po nxjerr arsye të pavlefshme për të justifikuar kriterin e mesatares.

Së dyti, siç mund ta shihni në faqen e tretë të shkresës së DAP është shprehur se ky vend është ofruar më parë për studentët ekselentë, pra sipas VKM nr. 586, dhe fituese është shpallur studentja ekselente Zj. C., e cila është punësuar me kontratë një vjeçare. Pas përfundimit të kontratës një vjeçare, u hap konkursi për lëvizjet paralele duke ndaluar dhe skualifikuar pjesëmarrjen në konkurs të gjithë nëpunësve civilë që nuk janë ekselentë, dhe tashmë është hapur konkursi për pranime nga jashtë shërbimit civil. Për çudi të të gjithëve, por jo timen, ky konkurim u lejohet vetëm ekselentëve pasi kërkohet mesatarja përsëri 9.00-10.00.

Siç e kam shprehur edhe në formularin e ankesës, tashmë më është forcuar dyshimi që ky proces është parapërgatitur për të favorizuar një person, Zj. C. Dua të sqaroj këtu që unë as nuk e njoh këtë person dhe as nuk kam asnjë gjë personale me të. Zj. C. ka fituar një herë këtë vend pune dhe është punësuar me kontratë një vjeçare. Kjo procedurë është realizuar në bazë të VKM nr. 586, datë 30.08.2019 "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore". Ky vendim, në piken 16 të tij shpreh që "Studentët e ekselencës kanë të drejtë të përfitojnë vetëm një herë nga skema e punësimit sipas procedurave të këtij vendimi". Meqënëse personi në fjalë nuk mund të aplikojë përsëri nëpërmjet VKM-së për ekselentët, gjithashtu nuk mund të aplikojë as për lëvizje paralele pasi ka patur kontratë një vjeçare, për të favorizuar sa më shumë këtë person, ndër kriteret skualifikuese të konkursit vendoset përsëri mesatarja 9.00-10.00. Natyrisht, ashtu siç unë e kam pritur, tek shpallja 3915 në faqen e DAP, Zj. C. rezulton fituese në fazën e parë tek konkursi i pranimit nga jashtë në shërbimin civil.

Së fundi, në kërkesën e KMD drejtuar MBZHR, në informacionet e kërkuara është edhe pyetja nëse ka aktualisht punonjës të emëruar në këtë pozicion pune. Dua të sqaroj që kontrata një vjeçare e Zj. C. mund të ketë përfunduar dhe përgjigja nga MBZHR mund të jetë që nuk ka aktualisht asnjë person të punësuar, rrjedhimisht me këtë arsyetim mund të mos dorëzojnë as dosjen e punonjësës në fjalë. Megjithatë, shkresa zyrtare e DAP që është bashkëngjitur konfirmon se kjo punonjëse e ka fituar më parë këtë vend pune me kontratë një vjeçare si studente ekselente...".

4. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 295/5 prot., datë 09.05.2022, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 16.05.2022, (duke qenë se, nga ana e palëve për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë në seancën e datës 16.05.2022, u vendos me dakordësinë e palëve realizimi i saj më datë 19.05.2022), vetëm me praninë e palëve ndaj të cilave është drejtuar ankesa. Subjekti ankues nuk u paraqit në seancën dëgjimore.

Departamenti i Administratës Publike u përfaqësua<sup>5</sup> në seancën dëgjimore, nga znj. A. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa MBZHR-së, u përfaqësua<sup>6</sup> nga znj. A. L., me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit. Palët në seancë i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsytimit të vendimit.

5. Nëpërmjet shkresës nr. 885 prot., datë 08.06.2022, Komisioneri i është drejtuar MBZHR-së dhe Departamentit të Administratës Publike, duke kërkuar informacion shtesë sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, MBZHR me shkresën<sup>7</sup> nr. 802/6 prot., datë 20.06.2022, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: *"...Institucioni jonë nuk gjen hapësirë për të relatuar në vijim pretendime shtesë në lidhje me procesin e marrë në shqyrtim nga ana e institucionit tuaj me ankues D. Sh..*

*Sa më sipër i qëndrojmë përgjigjes institucionale nëpërmjet shkresës drejtuar institucionit tuaj me Nr. 802/2, datë 2.3.2022 si dhe relatimeve të mbajtura në seancën dëgjimore të datës 19.5.2022.*

*Përsa i përket kërkesave tuaja shtesë, ju risqarojmë si me poshtë vijon: Është Departamenti i Administratës Publike (në vijim DAP) që në kuadrin e implementimit të planit vjetor të pranimi në shërbimin civil për vitin 2021, ka shpallur pozicionin Specialist (për Kooperimin dhe Ekonominë e Fermës) në Sektorin e Specialisteve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër me kodin #3915-lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike", niveli minimal i diplomës "Bachelor" për procedurat e lëvizjes paralele në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.*

*Në zbatim të pikës 3, të Kreut II, të Vendimit nr. 586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore", i ndryshuar, DAP shpall procedurën për shprehjen e interesit për*

---

<sup>5</sup> U përfaqësua me Autorizimin Nr. 3105 prot., datë 16.05.2022

<sup>6</sup> U përfaqësua me Autorizimin Nr. 802/4 prot., datë 18.05.2022

<sup>7</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 885/1 prot., datë 22.06.2022

*punësimin me kontratë të përkohshme 1-vjeçare të studentëve të ekselencës, në pozicionet specialist dhe të barazvlefshëm në institucionet e administratës shtetërore.*

*Në lidhje me procedurën e pranimit në shërbimin civil, mbështetur në nenin 22, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, punësimi në institucionet e administratës shtetërore, i cili është pjesë e shërbimit civil, kryhet nëpërmjet procedurës së rekrutimit, procedurë e cila zhvillohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) si njësi përgjegjëse.*

*Nga ana e MBZHR-së kryhet vetëm publikimi në portalin [administrata.gov.al](http://administrata.gov.al) për pozicionet të cilat janë vakant (sipas planit të nevojave për pranim në shërbimin civil), si dhe shkresa për fillimin e marrëdhënieve financiare brenda 5 ditëve pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga DAP, si njësi përgjegjëse.*

*Së treti, në lidhje me disa shpallje të ngjashme, për periudhën 2020-2022, sa më poshtë vijon gjeni shpalljen e DAP-it për vitin 2022.*

*<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6?excellence=6...>”.*

*Me shkresën nr. 3105/2 prot., datë 23.06.2022, DAP informoi Komisionerin ndër të tjera se: “Së pari, Departamenti i Administratës Publike, në kuadër të implementimit të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2021 ka shpallur pozicionin Specialist (për Koopenimin dhe Ekonominë e Fermës) në Sekionin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, -kategoria: IV-b, me kodin #3915- Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”, për procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.*

*Nëpunësja D. Sh., në pozicionin Specialiste finance në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, ka aplikuar në procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive, për pozicionin: Specialist (për Kooperimin dhe Ekonomikë e Fermës) në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, kategoria IV-b.*

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në respektim të parashikimeve të Kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, e ndryshuar, njësi e burimeve njerëzore e MBZHR-së ka skualifikuar D. Sh. nga procedurat e konkurrimit për shkak të mosplotësimit të kriterit të posaçëm, të mesatares së ponderuar 9.00-10.00.*

*Në datë 03.02.2022, aplikantja ka paraqitur në DAP kërkesën për informacion mbi procedurën me kod 3915- Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike”, niveli i diplomës “Bachelor”. Me shkresën nr. 744/1 prot., e datës 25.02.2022, “Kthim përgjigje”, Departamenti i Administratës Publike, i ka kthyer përgjigje D. Sh. me objektin e kërkesës.*

*Ndërkohë, D. Sh. ka aplikuar në procedurën e konkurrimit me kod#4024 “Lushnjë, Berat, Tiranë, Lezhë, Fier – Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, dhe në datën 10.05.2022 është emëruar në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Shkodër, Lezhë, Kukës, me vendndodhje, përsëri në qytetin e Lezhës ...*

*Lidhur me konstatimin e D. Sh. (citojmë ankesën...) 'duke qenë se bëhej fjalë për nëpunës që janë pjesë e shërbimit civil, ankuesja ka menduar se kriteri është vendosur gabimisht...', sqarojmë se në shpalljen publike të çdo pozicioni pune në shërbimin civil, në çdo fazë të procedurës përcaktohen edhe kriteret që duhet të plotësoj kandidati për fazën përkatëse të konkurrimit, me qëllim informimin e tij mbi plotësimin ose jo të kriterëve të kërkuara. Për fazën e lëvizjes paralele për pozicionin me kod #3915, në pikën 1.1 të shpalljes publike kërkohet që: Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:*

- a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtën kategori (ekzekutive);*
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;*
- c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".*

*Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:*

- a) Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Bachelor" në "Shkenca Ekonomike";*
- b) Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion;*
- c) Të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00-10.00 ose ekuivalent për studentët e diplomuar jashtë vendit.*

*Së dyti, përsa i përket Vendimit Nr. 586, datë 30.08.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore", e ndryshuar, sqarojmë se ky akt nënligjor është ndërmarrë në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese, si dhe objektivave social mbi punësimin e një kategorie të veçantë, siç janë të rinjtë e diplomuar me rezultate të shkëlqyera. Ky akt normativ synon njëkohësisht përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së nivelit të administratës shtetërore, duke punësuar më të aftët dhe më të mirët, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit publik, i cili është edhe objektivi kryesor i administratës publike.*

*Gjithashtu, ky Vendim përbën një "masë me karakter të përkohshëm (1 vjeçar)", pasi synon plotësimin e disa vendeve të kategorisë ekzekutive në shërbimin civil përkohësisht, vetëm për studentët ekselentë që kanë përfunduar studimet me mesatare 9.00-10.00. Për rrjedhojë, nuk cënohen të drejtat e individëve të tjerë që duan të konkurrojnë për t'u bërë pjesë e shërbimit civil, pasi objekti i këtij akti nënligjor është një grup i caktuar pozicionesh pune, pjesë e kategorisë ekzekutive, mbështetur në kriteret e përgjithshme të parashikuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave.*

*Studentët e ekselencës, të cilët kanë përzgjedhur një vend pune sipas VKM-së nr. 586, datë 30.08.2019, e ndryshuar, nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe në përfundim të periudhës 1-vjeçare të punësimit, këto pozicione shpallen për rekrutim sipas procedurave të konkurrimit të parashikuara në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.*

*Numri i pozicioneve të punës që ju ofrohen ekselentëve për çdo vit kalendarik, nuk do të jetë më i madh se një e treta e numrit të pozicioneve të institucionit. Në këtë mënyrë sigurohet funksionimi normal i institucioneve për realizimin e detyrave të tyre, si dhe balancimi midis nëpunësve me përvojë dhe ekselentëve, të cilët synojnë të krijojnë eksperiencë të vlefshme dhe të përfitojnë njohuritë e duhura.*

Në këtë linjë argumenti, janë të sanksionuara dhe parimet themelore të mirëfunksionimit të shërbimit civil si dhe kriteret e përcaktuar në këtë kuadër ligjor që rregullojnë pranimin në këtë shërbim.

Konkretisht, në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë përcaktuar kërkesat e përgjithshme që një kandidat duhet të plotësojë për t’u pranuar në shërbimin civil. Konkretisht, konkurenti duhet: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur; ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; h) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji; e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

Ndërsa, në lidhjen 2, me titull “Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori dhe klasë” dhe në pikën 6, të ndarjes me titull “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, që i bashkëlidhen si pjesë përbërëse vendimit të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, është parashikuar që kërkesat e posaçme të vendit të punës duhet të përmbajnë:

- profilin e arsimit të lartë që duhet të ketë aplikati/ja;
- nivelin e diplomës që ai/ajo duhet të zotërojë (diploma “Bachelor”, “Master profesional” apo “Master shkencor”);
- diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- kualifikime/trajtime të ndryshme;
- njohuri të një gjuhe të huaj.

Siç shihet, nga përmbajtja e sispozitave të sipërcituara, nuk rezulton që të jetë përmendur ndonjë kërkesë në lidhje me notën mesatare të studimeve universitare. Mirëpo, kërkesat e posaçme të pozicionit të punës si më sipër kanë karakter indikativ dhe jo taksativ. Po të shihet mënyra e ndërtimit të dispozitës së cituar më sipër, dallohet që aty janë renditur disa pika me kërkesa për profilin e arsimit të lartë, nivelin e diplomës..., etj, por nuk mund të pretendohet se kjo dispozitë ka karakter shterues dhe se përveç këtyre kërkesave të përmendura, nuk mund të shtohen kërkesa të tjera specifike, në përputhje me nevojat konkrete të punës objektivat e institucionit.

Vlen të përmendim këtu, raste ku për pozicione të kërkuara në shërbimin civil, kriteret e përcaktuara janë të ndryshme, të diktuar këto nga kuadri ligjor në fuqi, konkretisht:

1. “Specialist Auditit” kriteri i posaçëm është që kandidatët, të paktën të kenë 5 vite përvojë pune në profesion ose si auditues i brendshëm ose i jashtëm dhe të jenë të pajisur me certifikatën e “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”, kriteret të diktuar nga parashikimet e ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
2. Specialist Jurist në Seksionin për Shërbimin Juridik, Psikologjik dhe Mjekësor, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë, kriteri i posaçëm është që kandidatët të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me “Certifikatë

*Sigurie” të kategorisë B “Sekret”, sipas VKM nr. 188, datë 04.03.2015, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”;*

- 3. Specialist psikolog, kriteri i posaçëm është që kandidatët të jenë të pajisur me licencë për ushtrimin e profesionit, kriteri i diktuar nga parashikimet e ligjit nr. 40/2016 “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”;*
- 4. Specialist finance (nëpunës zbatues), kriteri i posaçëm është që kandidatët të kenë një diplomë të ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion, kritere të diktuar nga parashikimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”...*

*Referuar pozicioneve të sipërcituara rezulton se për shpalljen e një pozicioni vakant në shërbimin civil, përveç kriterëve minimale të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, mund të kërkohen që kandidatët të plotësojnë edhe kritere të tjera të veçanta të diktuar nga natyra e pozicionit të punës ose kuadri ligjor respektiv. Ndërkohë, në aktin administrativ-shpalljen publike të një pozicioni vakant, në respektim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative, evidentohet qartazi baza ligjore që normon procesin e rekrutimit në shërbimin civil, duke filluar nga shpallja e një pozicioni vakant dhe deri te shpallja e fituesit. Për rrjedhojë, në bazën ligjore ose nënligjore të shpalljes publike të një vakance nuk mund të përfshihen akte ligjore ose nënligjore, të cilat si nga pikpamja materiale ashtu edhe procedurale nuk rregullojnë apo parashikojnë elemente që lidhen me procesin e rekrutimit në shërbimin civil.*

*Gjithashtu, edhe në rastin objekt shqyrtimi, theksojmë se, nuk mund të përfshihet në bazën ligjore të shpalljes së një pozicioni vakant në shërbimin civil, akte normative të cilat rregullojnë një formë të ndryshme punësimi nga ajo e parashikuar në legjislacionin e shërbimit civil, konkretisht Vendimin nr. 586, datë 30.08.2019, i Këshillit të Ministrave, i cili normon punësimin e përkohshëm të ekselentëve me mesatare 9.00-10.00, pasi ky fakt do të përbënte element për goditjen e ligjshmërisë së këtij akti administrativ.*

*Lidhur me shpalljen e pozicioneve të punës të cilat janë plotësuar përkohësisht me studentë të ekselencës, vendimi nr. 586, datë 30.08.2019, i Këshillit të Ministrave, në pikën 14, të Kreut II, përcakton se në përfundim të kontratës 1-vjeçare, të lidhur sipas këtij vendimi, ata që dëshirojnë të jenë pjesë e shërbimit civil do t'i nënshtrohen procedurave të konkurrimit, sipas legjislacionit të shërbimit civil, DAP, vijon me shpalljen e këtyre pozicioneve në respektim të parimeve të legjislacionit të shërbimit civil.*

*Gjithashtu, lidhur me ligjshmërinë e vendosjes si kriter paraseleksionues të notës mesatare të studimeve universitare (9-10), me Vendimin nr. 52, të datës 07.07.2020, “Për vlerësimin e ligjshmërisë të veprimit administrativ, të vendosjes si kriter paraseleksionues të notës mesatare të studimeve universitare (9-10), që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë për procedurat e lëvizjes paralele, pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për vendet vakante në institucionet e administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, të publikuara në faqen zyrtare të DAP”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (vendim i vënë në dispozicion të Komisionerit nga përfaqësuesi i DAP në seancën dëgjimore të datës 19.05.2022), është shprehur*

se vendosja e notës mesatare të studimeve universitare, si kërkesë për t'u plotësuar nga kandidatët që aplikojnë për një procedurë konkurrimi, nuk përbën shkelje të parimit të shanseve të barabarta, kjo bazuar edhe në faktin se, konkurrimet për të cilat është vendosur si kusht shtesë nota mesatare, janë pozicione të dedikuara për punësimin e ekselentëve në respektim të VKM-së Nr. 586, datë 30.08.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”.

Duke iu referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vendimin nr. 215, datë 11.11.2021, në faqen 10 të tij ka arsyetuar se: “Si rregull, trajtimi i pafavorshëm, do të përcaktohet si diskriminim, si rezultat i krahasimit të një personi në një situatë të ngjashme. Si ilustrim mund të përmendim p.sh. një ankesë për një pagë ‘të ulët’ nuk është pretendim për diskriminim po të mos të demonstron se paga më e ulët sesa paga e dikujt të punësuar për kryerjen e një detyre të ngjashme nga i njëjti punëdhënës. Për rrjedhojë nevojitet një ‘krahasues’, pra një person a grup personash, në rrethana materialisht të ngjashme, me ekzistencën e ndryshimit kryesor ndërmjet personave është ‘shkaku i mbrojtur”.

Në këto kushte, që të përcaktohet nëse ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme me kandidatët e tjerë, nevojitet të identifikohet krahasuesi, gjë që nuk identifikohet nga ana e ankueses.

...në përfundim të afatit një vjeçar të kontratës së punësimit të përkohshëm, DAP kërkon nga institucionet e administratës shtetërore ku janë punësuar ekselentët, të marrin masat për publikimin në sistemin online të rekrutimit këto pozicione, me qëllim plotësimin e vakancës së krijuar në zbatim të parashikimit të pikës 14 të VKM-së nr. 586, datë 30.08.2019. Konkretisht, me e-mail e datës 13.01.2022 DAP ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të MBZHR-së deklarin në HRMIS (të vakancës Specialist (për Kooperimin dhe Ekonomikë e Fermës) në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër)...

...DAP, nëpërmjet e-mail të datës 26 tetor 2020, informoi sistemin e Kryeministrit dhe ministritë e linjës mbi fillimin e procesit të përgatitjes së shpalljes për thirrjen e punësimit të studentëve të ekselencës për vitin 2020, duke evidentuar edhe numrin e pozicioneve vakante në institucione dhe kuotat që vlerësohen t'i dedikohen kësaj thirrjeje. Vlen të përmendim këtu, se në respektim të VKM-së nr. 586, datë 30.08.2019, pika 3, numri i pozicioneve, që do të vihen në dispozicion të studentëve të ekselencës, për çdo vit kalendarik, nuk mund të jetë më i madh se një e treta e numrit të pozicioneve të institucionit.

Gjithashtu, është kërkuar nga sistemi i MBZHR-së, të përcillen të dhënat lidhur me pozicionet e kategorisë ekzekutive të cilat vlerësohen se mund të plotësohen nëpërmjet punësimit të përkohshëm të ekselentëve. Me e-mail e datës 29 tetor 2020, njësia e burimeve njerëzore në MBZHR ka përcjellur vendet vakante të këtij sistemi ministror, të cilat do të ofroreshin për punësimin e ekselentëve, përfshi edhe pozicionin ‘Specialist (për Kooperimin dhe Ekonomikë e Fermës) në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

## A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, D. Sh., është punonjëse e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, ku ushtron detyrën e Financieres.

Referuar Rregullores së Brendshme e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Nr. 9034/1 prot., datë 07.11.2018, ndër institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pjesë e së cilës është edhe institucioni në të cilin ushtron detyrën ankuesja, pra Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës.

Në muajin janar 2022, ankuesja është vënë në dijeni të shpalljes nr. 3915, të publikuar<sup>8</sup> në faqen web të Departamentit të Administratës Publike, për një vend pune në pozicionin Specialist për Kooperimin dhe Ekonominë e Fermës, në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër.

Referuar VKM-së Nr. 147, datë 13.3.2018 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor”*, Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor janë institucione në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, pra në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Urban.

Sipas njoftimit të bërë publik, citohej se: *“Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.”*

Duke qenë se vendi i saj i punës është në qytetin e Lezhës dhe ajo jeton në Shkodër, ka paraqitur dokumentacionin përkatës për t’u transferuar me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin e shpallur nga ana e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër.

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

1. Specialist (për Kooperimin dhe Ekonominë e Fermës) në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, - kategoria: IV-b

Në pikën 1.1 të publikimit për vendin vakant, janë shpallur kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta, si më poshtë: “

---

<sup>8</sup> <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3419>

*Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:*

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);*
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;*
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.*

*Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:*

- a. Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Bachelor" në "Shkenca Ekonomike".*
- b. Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion;*
- c. Të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00–10.00 ose ekuivalent për studentët e diplomuar jashtë vendit.*

*KUJDES: Kandidatët duhet të dorëzojnë listën e notave të nivelit Bachelor dhe/ose të nivelit Master ku të jetë e përfshirë mesatarja e ponderuar ose vërtetim nga fakulteti përkatës lidhur me mesataren e ponderuar. Dorëzimi i dokumentacionit përbën kusht për kualifikimin e kandidatit në procedurë.”*

*Në përfundim të aplikimit online, dokumentat e përmendura më sipër, së bashku me një kërkesë ku ju specifikoni pozicionin ku dëshironi të konkuroni, duhet të dorëzohen pranë institucionit që ka pozicionin vakant për të cilin ju aplikoni 29/01/2022”.*

Në momentin e marrjes disjени të pozicionit të shpallur vakant, ankuesja është njohur me kriteret e lëvizjes paralele për këtë pozicion pune dhe ka evidentuar se një prej tyre ishte ai i mesatares, ku kërkohej “*Të ketë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00-10.00*”. Pavarësisht këtij fakti, ankuesja pasi ka aplikuar online, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar për procedurën e lëvizjes paralele nëpërmjet postës me datë 28.01.2022. Më datë 31.01.2022, është njoftuar nga ana e MBZHR-së se është skualifikuar pasi nuk ka dorëzuar pranë institucionit dokumentacionin e plotë brenda afatit.

Referuar informacionit të administruar, ankuesja me shkresën datë 01.02.2022, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, duke i kërkuar informacion sa i përket pozicionit të shpallur vakant dhe sqaruar se: “*...Siç jeni në dijeni, në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike është publikuar shpallja nr. 3915 për lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive në pozicionin Specialist në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër. Duke marrë shkas nga ky njoftim, kam dorëzuar brenda afatit kohor të caktuar, konform kërkesave të njoftimit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.*

*Dje jam njohur me lajmërimin e shpallur nga DAP në lidhje me këtë proces ku shprehet që nuk ka asnjë person të kualifikuar për fazën e dytë, duke nënkuptuar edhe skualifikimin tim.*

*Për sa më sipër do tju lutesha të më informoni në mënyrë të detajuar në lidhje me arsyet e skualifikimit tim.*

*Gjithashtu, mundësisht më informoni a është marrë për bazë në këtë shpallje VKM-ja nr. 586 dt. 30.08.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, pra a është bërë njoftimi vetëm për studentët e ekselencës?*

*Dhe së fundi, në këtë vend pune për të cilin është zhvilluar kjo procedurë punësimi, a ka qenë i punësuar ndonjë student i ekselencës që të ketë përfituar nga VKM-ja nr. 586 dt. 30.08.2019? ”.*

Më datë 07.02.2022, është njoftuar me anë të e-mail-it nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore në MBZHR, për skualifikimin e saj për disa arsye, nëpërmjet të cilit sqarohet se: “

- *Nuk plotësoni kriterin e mesatares së ponderuar si kriter i vendosur për pozicionin e punës (Të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00-10.00 ose ekuivalent për studentët e diplomuar jashtë vendit);*
- *Vërtetimi i masës disiplinore nuk është i muajit të fundit;*
- *Raportin mjekësor nuk është datat e marrjes nga mjeku;*
- *Nuk keni sjellë vlerësimin e rezultateve në punë për 6-mujorin e fundit (vlerësimi është i 6 mujorit të parë të vitit 2021).*

*Mbështetur në pikën 11, Kreu VII, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015 e ndryshuar, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, keni të drejtë të paraqisni ankesë me shkrim”.*

Sipas ankueses, vendosja e një kriteri të tillë gjatë procedurave të lëvizjes paralele, është jashtë çdo standardi dhe diskriminues, pasi ka sjell përjashtimin dhe ndalimin e të gjithë kandidatëve, nëpunës të shërbimit civil në pozicione të kategorisë ekzekutive, por që nuk kanë mesataren e studimeve mbi 9.00.

Në përgjigje të kërkesës së D. Sh., të datës 01.02.2022, Departamenti i Administratës Publike me anë të shkresës nr. 744/1 prot., datë 25.02.2022, ka sqaruar ndër të tjera se, procedura e konkurrimit për këtë pozicion është kryer në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të pikës 14, të VKM nr. 586, datë 30.08.2019, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”.

Referuar legjislacionit për nëpunësin civil, në nenin 22, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, parashikohet:

1. *Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur.*
2. *Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji.*
3. *Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza:*

*a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;*

*b) vlerësimi i kandidatëve.*

4. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i përhershëm i pranimit, i krijuar për secilin nga grupet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 19 të këtij ligji...”.

Në Kreun II, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, përcaktohen procedurat në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, ku ndër të tjera citohet se: “1. Procedura e pranimit në shërbimin civil organizohet vetëm për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë organizohet në mënyrë të ndarë për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm.

2. DAP-i organizon procedurën e pranimit për të gjitha pozicionet e kategorisë ekzekutive për administratën shtetërore, ndërsa njësitë përgjegjëse në institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore organizojnë procedurën për institucionet respektive.

3. DAP-i për pozicione pune që i përkasin institucioneve rajonale/vendore të ministrive apo të institucioneve të varësisë mund të organizojë procedurën e pranimit për secilin grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm apo për grupin e administrimit të përgjithshëm edhe mbi baza qarku.

4....

5. Për institucionet e administratës shtetërore, shpallja e procedurës së pranimit për secilin grup publikohet në faqen zyrtare të DAP-it dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe qëndron e publikuar, të paktën deri në përfundimin e procedurës së pranimit.

6. Institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore bëjnë shpalljen e procedurës së pranimit për secilin grup në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në standat e informimit të publikut, si dhe në faqen e tyre të internetit në rast se kanë.

7...

8...

9. Shpallja në faqen zyrtare të DAP-it apo të institucioneve të pavarura dhe njësive të qeverisjes vendore dhe në portal përmban këto të dhëna:

a) fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;

b) fazat në të cilën do të kalojë konkurrimi, me shkrim dhe me gojë;

c) numrin e vendeve të planifikuara për të cilat do të bëhet pranimi;

ç) kërkesat e përgjithshme, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;

d) përshkrimin e përgjithshëm të punës së grupit/grupeve të administrimit të përgjithshëm/të posaçëm, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi;

dh) kërkesat e veçanta të grupit të administrimit të përgjithshëm/të posaçëm;

e) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;

ë) afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;

f) datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve;

g) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe në fazën e vlerësimit të kandidatëve;

gj) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

10. Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët nga jashtë shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në:

a) faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për institucionet e administratës shtetërore;

b) portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.”

Në Kreun IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, përcaktohen ndër të tjera se: “1. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) Vlerësimi i kandidatëve.

2. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

3. Në përfundim të verifikimit, sipas pikës 2 të kreut IV të këtij vendimi, kandidatët, të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik.

4. Lista e përmendur në pikën 3 të kreut IV të këtij vendimi administrohet nga njësia përgjegjëse dhe shpallet në:

a) Faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për administratën shtetërore;

b) Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyt e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 5 të kreut IV të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit... ”.

Ndërsa në Kreun VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përcaktohen procedurat e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive, ku ndër të tjera citohet se: “1. Procedura e lëvizjes paralele bëhet për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, në çdo institucion të shërbimit civil.

2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;

b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

ç) të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

3. Shpallja për vendin e lirë, që do të plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, bëhet sipas pikave 4, 5, 6 dhe 7 të kreut II të këtij vendimi.

4. ...

5. Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil. Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vendin e lirë. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

6. Procedura e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

a) verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

7. Njësia e burimeve njerëzore, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

8. ...

9. ...

10. Kandidatët që nuk kualifikohen, njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit për shkaqet e moskualifikimit, në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

11. Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual në përputhje me pikën 10 të kreut VII të këtij vendimi, kanë të drejtë të paraqesin ankesat me shkrim në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit që ka vendin vakant. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit...”.

Sa më sipërcituar, Departamenti i Administratës Publike ka publikuar shpalljen e procedurës për lëvizje paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin vakant. Sipas legjislacionit, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për

procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rastet se ky pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, atëherë është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategoritë ekzekutive.

Sa më sipër, ankuesja ka dorëzuar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Kërkesë për lëvizje paralele” protokolluar me Nr. 622, datë 31.1.2022. Nëpërmjet e-mailit më datë 07.02.2022, ankuesja është njoftuar nga ana e burimeve njerëzore të MBZHR-së, se: “

- Nuk plotësoni kriterin e mesatares së ponderuar si kriter i vendosur për pozicionin e punës (Të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00-10.00 ose ekuivalent për studentët e diplomuar jashtë vendit);
- Vërtetimi i masës disiplinore nuk është i muajit të fundit;
- Raportin mjekësor nuk është datat e marrjes nga mjeku;
- Nuk keni sjellë vlerësimin e rezultateve në punë për 6-mujorin e fundit (vlerësimi është i 6 mujorit të parë të vitit 2021).

*Mbështetur në pikën 11, Kreu VII, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015 e ndryshuar, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, keni të drejtë të paraqisni ankesë me shkrim”.*

Në përgjigje të kërkesës së D. Sh., të datës 01.02.2022, Departamenti i Administratës Publike me anë të shkresës nr. 744/1 prot., datë 25.02.2022, fillimisht ka sqaruar procedurën e ndjekur për shpalljen e pozicionit vakant. Me tëj, ndër të tjera sqaron se: “...përsa i përket pyetjes tuaj, nëse pozicioni i sipërpërmendur është ofruar vetëm për studentët e ekselencës, sqarojmë se procedura e konkurrimit për këtë pozicion është kryer në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të pikës 14, të VKM nr. 586, datë 30.08.2019, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”. Në respektim të pikës 3 dhe 5, të kreut II dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave. “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, shpallja e procedurës së pranimit për secilin grup është publikuar në faqen zyrtare të DAP-it.

*Në këtë procedurë konkurrimi mund të aplikojnë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë. Nëse procedura e lëvizjes paralele mbyllet pa fitues vijohet me pranimin nga jashtë shërbimit civil, për të cilën mund të aplikojnë të gjithë kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme.*

*... referuar kërkesës suaj nëse në pozicionin e sipërpërmendur ka përfituar ndonjë student i ekselencës më parë ju informojmë se, nga të dhënat e administruara, në zbatim të VKM nr. 586, datë 30.08.2019, ‘Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore’, rezulton se pozicioni Specialist (për Kooperimin dhe Ekonominë e Fermës) në Sektorin e Specialistëve të Profilizuar, në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, kategoria: IV-b, është ofruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për punësimin e*

*përkohshëm të ekselentëve. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes sipas renditjes me pikë, ky pozicion është zgjedhur nga znj. C.”*

Pra, sipas informacionit të dhënë nga DAP, procedura e konkurrimit për këtë pozicion është kryer në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe të pikës 14, të VKM nr. 586, datë 30.08.2019, *“Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”*.

Në vijim, ankuesja është bërë me dije se në zbatim të pikës 11, Kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim. Nga informacioni i administruar nga palët në proces, nuk rezulton që ankuesja të ketë paraqitur ndonjë ankesë lidhur me procedurën e konkurimit dhe faktin që nuk është kualifikuar në fazën e dytë të tij. Gjithashtu, nga informacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton që kandidatë të tjerë të kenë kundërshtuar vendosjen e kriterit të mesatares për procedurën e lëvizjes paralele..

Në analizë të informacionit të sipërcituar, rezultoi se ankuesja nuk ishte kualifikuar për të vijuar procedurën e mëtejshme të konkurimit jo vetëm për shkak të kërkesës së posaçme *“Të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00–10.00 ose ekuivalent për studentët e diplomuar jashtë vendit”*, por edhe për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara për lëvizjen paralele. Pra, në këtë kuptim, skualifikimi i ankueses gjatë procedurës së lëvizjes paralele nuk ka ardhur vetëm si rezultat i kërkesës së posaçme të pozicionit të shpallur, por edhe për arsytet e sipërcituara.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

Nga informacioni i administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri evidentoi se VKM-ja Nr. 586, datë 30.08.2019, *“Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”*, e ndryshuar, është ndërmarrë në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese, si dhe objektivave social mbi punësimin e një kategorie të veçantë, siç janë të rinjtë e diplomuar me rezultate të shkëlqyera. Ky akt normativ synon njëkohësisht përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së nivelit të administratës shtetërore, duke punësuar më të aftët dhe më të mirët, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit publik, i cili është edhe objektivi kryesor i administratës publike. Ky Vendim përbën një *“masë me karakter të përkohshëm (1 vjeçar)”*, pasi synon plotësimin e disa vendeve të kategorisë ekzekutive në shërbimin civil përkohësisht, vetëm për studentët ekselentë që kanë përfunduar studimet me mesatare 9.00-10.00. Për rrjedhojë, objekti i këtij akti nënligjor është një grup i caktuar pozicioneve pune, pjesë e kategorisë ekzekutive, mbështetur në kriteret e përgjithshme të parashikuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave.

Studentët e ekselencës, të cilët kanë përzgjedhur një vend pune sipas VKM-së nr. 586, datë 30.08.2019, e ndryshuar, nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe në përfundim të periudhës 1-vjeçare të punësimit, këto pozicione shpallen për rekrutim sipas procedurave të konkurrimit të parashikuara në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Numri i pozicioneve të punës që ju ofrohen ekselentëve për çdo vit kalendarik, nuk duhet të jetë më i madh se një e treta e numrit të pozicioneve të institucionit. Në këtë mënyrë sigurohet funksionimi normal i institucioneve për realizimin e detyrave të tyre, si dhe balancimi midis nëpunësve me përvojë dhe ekselentëve, të cilët synojnë të krijojnë eksperiencë të vlefshme dhe të përfitojnë njohuritë e duhura.

Nga analiza e informacionit të sipërcituar, evidentohet se institucionet e administratës shtetërore, pasi kanë vlerësuar pozicionet vakante të punës, çdo vit kanë ofruar një të tretën e pozicioneve për punësimin e përkohshëm të studentëve ekselentë që kanë përfunduar studimet me mesatare 9.00-10.00. Në përfundim të periudhës 1-vjeçare të punësimit të tyre, këto pozicione shpallen për rekrutim sipas procedurave të konkurrimit të parashikuara në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Pra, rezultojnë se pozicionet vakante të shpallura më parë për studentët e ekselencës, janë pozicione të dedikuara për punësimin e ekselentëve në respektim të VKM-së Nr. 586, datë 30.08.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” dhe për këtë në konkurrimet në vijim vendoset si kusht shtesë nota mesatare.

Gjithashtu, nga tërësia e informacionit të analizuar, rezultoi se:

- Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për shpalljen dhe rekrutimin e nëpunësve civil, në rastin konkret edhe për ankuesen;
- Ankuesja nuk është vendosur në kushte të pafavorshme nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pasi ajo nuk ishte kualifikuar për të vijuar procedurën e mëtejshme të konkurimit jo vetëm për shkak të kërkesës së posaçme “Të kenë përfunduar studimet universitare me mesatare 9.00–10.00...”, por edhe për shkak të mosplotësimit të kushteve të tjera të përcaktuara për lëvizjen paralele.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në

*nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankueses D. Sh., nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja arsimore)  
(Fusha: Punësim)